



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 7550
Data: 09 . 09 . 2022

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR ME GRATË NGA KOMUNA E HANIT
TË ELEZIT**

Procesverbali nga Dëgjimi i tretë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025, të mbajtur me datën **22.08.2022**, duke filluar nga ora **18:00** në **Sallën e Takimeve**, në objektin e Komunës së Hanit të Elezit që gjendet në katin e I-rë, me gjithsej 27 pjesëmarrës, prej tyre 25 gra dhe 2 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Nënkryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z. Sevdin Dernjani**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Lindita Ballazhi, si dhe drejtore të drejtorive.

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës **z. Sevdin Dernjani** i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hani të Elezit për vitin 2023, si dhe parashikimi për vitet 2024-2025, ku për rend të punës, ishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025**
2. **Diskutimi**

Sevdin Dernjani thekson: Prezentimin e këtij draft buxheti do ta bëjë Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Lindita Ballazhi.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor)

Lindita Ballazhi thekson: Ashtu sikur në jetën private, çdo individ me të hyrat që inkason, bën një planifikim për kostot e tij të jetës, për veshmbathje, për ushqim dhe shpenzime të tjera. Ashtu

edhe në rastin e Komunës, buxheti paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm financiar në të cilin specifikohen të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore një vjeçare, duke filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor. Planifikimi i Buxhetit Komunal kalon nëpër disa faza, bazuar në Ligjin Nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Planifikimi buxhetor fillon me lëshimin e Qarkores së parë Buxhetore nga Ministria e Financave që bëhet së fundi deri me 15 maj. Faza e dytë është hartimi i KAB-it në bazë të Qarkores Buxhetore ku kemi kufijtë fillestarë buxhetor. Për hartimin e KAB-it ne kemi mbajtur konsulta me asamblesë komunale, dëgjime buxhetore me qytetarët, si dhe është bërë miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal më 30 qershor. Faza vijuese është pranimi i Qarkores së dytë Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, e cila lëshohet më 15 gusht dhe më pas kemi bërë përgatitjen e draft buxhetit, si dhe vijon mbajtja e dëgjimeve publike. Faza përfundimtare e planifikimit buxhetor është miratimi i draft buxhetit në Kuvend Komunal, dhe veprimi i fundit është dorëzimi i draft buxhetit në Ministri të Financave deri më së voni 30 shtator. Buxheti i komunës përfshin këto struktura të financimit, ku për vitin 2023 do të jenë: granti i përgjithshëm (1,431,545€), granti specifik për arsim (993,487€), granti specifik për shëndetësi (364,561€) dhe të hyrat vetanake komunale (560,121€). Pra, buxheti total për vitin 2023 do të jetë 3,349,714€. Në vazhdim, kemi bërë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2023, siç e shihni në projektor, këtu kemi të përfshime drejtoritë komunale, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe arsim dhe shkencë. Ndarja e buxhetit është bërë në bazë të kufijve buxhetor, për çdo kategori buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të dukshme në të gjitha kategoritë buxhetore. Mandej vijojnë të gjitha projektet kapitale të cilat i keni para vetes tuaj në letër, të cilat janë planifikuar nga drejtoritë dhe ekzekutivi, si dhe disa janë marrë edhe nga dëgjimet paraprake që kemi pasur në qershor dhe nuk po ju detajeve. Nëse keni ju ndonjë projekt propozim apo kërkesë çfarëdo qoftë, mundeni ta parashtroni.

2. Diskutimi

Sevdi Dernjani: Atëherë, pas prezentimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për ju, ju lutem kushdo që ka diçka me thanë apo me propozu, jeni të hapur.

Ardit Kuka: Unë jam Ardit Kuka, pjesë e organizatës Up To Youth të cilët në Han të Elezit në bashkëpunim me USAID operojnë tash e dy vjet, ku është organizatë që përkrah rininë, Hendikosin apo edhe gratë, kshu që çka do që munden me pas si ide apo propozim, mundemi me e paraqit edhe ne, që në bashkëpunim me Komunën me i realizu, siç ishte edhe kërkesa e HEndikos që Komuna ua ka siguru zyrën në Shpi të Kulturës, kurse ne kemi apliku për inventarizim të kësaj zyre dhe jemi në pritje të aprovimit të kërkesës. Kurse te gratë, në Han të Elezit nuk është që ka shumë gra që kanë bizneset e tyre, por 90% e tyre kanë një zanat apo diçka me të cilën merren dhe synimi është që të krijojmë diçka më afatgjatë.

Lindita Baku Dernjani: Unë mendoj se nashta do duhej me gra një buxhet ekstra për gratë, me persona ekstra të veçantë për me u merr me hulumtim ose aktivitete të ndryshme.

Lindita Ballazhi: Tek çështja e një buxheti të veçantë vetëm për gratë, dua të sqaroj se ne nuk jemi ata që vendosim se ku do të shpenzohen paratë, për projektet po, por nga ana tjetër kategori buxhetore janë të caktume me kufi buxhetor prej Ministrisë, si shembull drejtoria e Zhvillimit

Ekonomik, drejtoresha ka dashtë që t'i subvencionojë bizneset, mirpo Ministria nuk ia lejon. Kështu që me këtë mundësi që e kemi, ne i marrim mendimet dhe propozimet e qytetarëve, duke përfshi këtu edhe gratë patjetër për problemet që ato mund t'i kenë hasur kudo.

Nerxhivane Berisha: Mendoj se kishte me qenë mirë që me ftu gra te shtëpia e kulturës, edhe me thirr edhe gra profesioniste në fusha të caktume, sociologe, psikologe ose juriste edhe me ju dhanë këshilla të ndryshme të fushës së tyre grave, si shembull e drejta e trashëgimisë, ose rreth bullizmit, e të ngjajshme.

Erza Suma: Prioritet në Han të Elezit është vetëdijësimi dhe fuqizimi i grave, dhe një nga metodat është organizimi i punëtorive ose takime të ndryshme të shpeshhta, për me i vetëdijësu, sepse ka akoma mungesë informacioni për të drejtat e grave që vet ato nuk i dijnë që i kanë. E dyta çështje është ajo e arsimit, dhe tek projektet e paraqitura po shoh vetëm rregullim i infrastrukturës dhe vetëm ndërtime dhe unë e mendoj se është e nevojshme me u përfshi trajnime për të rinjtë rreth aftësive të buta apo soft skills.

Nerxhivane Berisha: Unë e kam propozu edhe te debati ma herët, çështjen e trotuareve, ku unë si person me aftësi e kam të vështirë te pjerrtësinat e trotuareve që shpesh kam vështirësi me kalu rrugën, po edhe nanat me fëmijë e kanë këtë problem. Gjithashtu, një pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë, a ekziston mundësia me e sjellë një gjinekologe në Han të Elezit?

Kimete Kuka – Hasallari: Këto ide janë shumë të mira për të cilat mudn t'i planifikojmë në të ardhmen, Jo vetëm për gjinekologë, por edhe fizioterapeutë. Ne Në Han të Elezit i kemi vetëm 32 punëtorë shëndetësorë, edhe pse kemi evojë për më shumë, kaq na lejon Ministria. Por për vitin e ardhshëm, mund të angazhojmë punëtorë shëndetësor me kontrata mbi vepër, sepse mundësi të tjera nuk kemi.

Mevlude Kamishi – Ballazhi: Po shoh e janë paraparë disa anekse, por jo te çerdhja. Dhe kërkoj që një aneks të jetë edhe te çerdhja, dhe tash që ka dal aplikimi, po ka shumë kërkesa dhe mendojmë se shtimi i hapësirave, shton edhe numrin e lejuar për fëmijë, kështu edhe nanave që duan me ndjek mësimet ose punë dhe shkak se duhet me u kujdes për fëmijët, shpesh detyrohet mos me vazhdu karrierën e as ndonji zanat që ka. Kjo përveç që ndihmon që më shumë fëmijë të kenë mundësinë të socializohen përmes çerdhes, por edhe shumë nana me pas mundësinë me ndjek karrierën, dhe gjithashtu te çerdhja mungon infermiera, psikologjia, kopshtar etj. Me kërkesë të prindve por edhe me udhëzim administrativ, kërkohet që tashmë edhe parafilloren me kry në çerdhe.

Lindita Bakiu Dernjani: Tek një takim më herët që kemi qenë, kemi diskutu për një kalim nga çerdhja për me lidh me pjesën nënhekurudhë, për automjete, sepse për këmbësorë ekziston jo formalisht një kalim aty, që ata që jetojnë atë pjesë mos me kalu rreth e rrotun për me ardh në qytet e shpesh kolonat e gjata po krijojnë rrugë të mbingarkume, e kjo rrugë që po them kish me qenë një rrugë alternative që e kish shkarku komunikacionin në pjesën e kufirit dhe poashtu edhe kolonat kishin mos me kriju problem te banorët e Hanit të Elezit. Sa e di në projekt komunal është kjo, por nuk është ndërmarrë kurgjo deri tani. Dhe besoj se tani është koha e fundit me ndërmarrë diçka, një marrëveshje me hekurudhat që me u leju diçka e tillë, sepse nëse veç kryhen punimet në hekurudhë, ka me qenë e vështirë.

Sevdi Dernjani: Kam pas takim me zv.ministrin Durmishi për këto çështje dhe ai ka thanë që nuk parashohin me lanë vendkalime pa u rregullu infrastruktura e hekurudhës. Ata gjithashtu kanë paraparë që edhe dy vendkalime ekzistuese me i mbyll, ajo te ranat dhe te bllaca 99, dhe kërkesat tona të vazhdueshme kanë qenë që me i lanë shkak se ju mbyllen rrugët edhe ju kemi kërku që me ju lanë ato vendkalime deri sa të gjenden rrugë alternative tjera. Dhe sipas ministrive, na kanë thanë që s'ka me pas problem me ndërhy te këto vendkalime edhe masi t'kryhen punimet në hekurudhë.


Nerxhivane Berisha: Te çështja e ujit, çka është tu ndodh?

Sevdi Dernjani: Jemi në fazën finale të punimeve, çështja ka mbetë tek një trafo që ka ardh me parametrat gabim, dhe jemi duke prit, por edhe orëmatësit janë tu fillu me u vendosë, dhe normalisht me funksionalizimin e fabrikës, uji ka me ardh edhe i pastërt edhe i pijshëm.

Sevdi Dernjani: A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor për gratë.

Mbledhja përfundoi në ora 18:45.

**Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi**



**Nënkryetari i Komunës
Sevdi Dernjani**

